

Njoftim për përqendrimin me të cilin Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited Irlandë fiton kontrollin mbi Maks Bet d.o.o. Novi Sad, Serbi

(lënda nr. 08-143/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 28.09. 2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited Irlandë (Flutter Entertainment Holdings Ireland Limited), me zyrë të regjistruar në Belfild Ofis Park, Biiç Hill Roud, Klonskig, Dablin 4 , Dablin D04 V972, Irlandë, mbi Maks Bet d.o.o. Novi Sad (Max Bet d.o.o. Novi Sad), me seli në Kisaçka 82, Novi Sad, Serbi.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited i përket Grupit të Shoqërive Flutter ("Grupi Flutter").

Grupi Flutter është një grup shoqëri që janë aktive në nivel global në sektorin e basteve sportive dhe organizimit të lojërave (aktivitetet e lojërave). Grupi Flutter ka katër seksione:

- Mbretëria e Bashkuar & Irlanda, e përqendruar në markat e basteve sportive dhe lojërave në Mbretërinë e Bashkuar ("MB") dhe Irlanda e cila operon kryesisht në internet (por edhe përmes librarive në MB dhe Irlandë);
- Australia, e përbërë nga marka e basteve sportive në internet(online) Sportsbet, një korporatë bastesh në Australi;
- SHBA, e cila përbëhet nga FanDuel, TVG dhe PokerStars. Seksioni zotëron një ofertë të ndryshme produktesh të buletineve online dhe të shitjes me pakicë për baste sportive, lojëra online, poker, baste të avancuara të depozitave në garat me kuaj dhe transmetim televiziv;
- Internacional, e cila menaxhon markat PokerStars, PokerStars Casino, PokerStars Sports, Betfair International, Sisal, Adjarabet dhe Jungle Games; ku Grupi Flutter operon me licenca në afërsisht 22 vende të botës.

Grupi Flutter ka një shoqëri të varur e të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria e programimit kompjuterik SINGULAR GROUP SHPKNJP Shkup, me seli në Franz Mesesnel nr. 2 Shkup - Karposh, Maqedonia e Veriut dhe aktivitet prioritar i regjistruar - programim kompjuterik (shifra 62.01).

Maks Bet d.o.o. Novi Sad është aktiv si organizator i lojërave të fatit. Maks Bet d.o.o. Novi Sad është aktiv vetëm në baste me pakicë në Maqedoninë e Veriut. Maks Bet d.o.o. Novi Sad ka një shoqëri të varur e të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit MAKS BET SHPKNJP Shkup me seli në Skupi nr. 1 G-1 /d.p.1 Shkup-Karposh dhe aktiviteti prioritar i regjistruar – lojërat e fatit dhe bastet (shifra 92.00).

Sipas parashtresit të njoftimit, si treg përkatës për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të përcaktohet *tregu i përgjithshëm i lojërave të fatit (përfshirë bastet dhe lojërat), në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

04.10.2023

Shkup